

PASQYRIMI I FAKTIT HISTORIK NË KËNGËT EPIKE TË SHEKULLIT XIX

Epika historike e shek. XIX për rajonin e Shkodrës është shumë e pasur, sepse edhe ngjarjet e përmasave kombëtare në të cilat ky qytet mbajti mbi supe pjesën e historisë që i takoi, kanë qenë intensive. Studimi synon lidhjen e fakteve historike me vargjet e krijuara nga populli, duke përjetësuar në këngë përpjekjet intensive në shekullin e fundit të pushtimit osman për të fituar pavarësinë.

Nuk u pa e nevojshme të përcaktohet nëse krijimet e marra për referencë i përkasin qytetit apo rrethinave fshatare, sepse ngjarjet historike u përballuan nga i gjithë populli. Këto ngjarje i bëri objekt të qindra këngëve popullore, duke ruajtur karakteristikat specifike të pasqyrimin. Shkodra me fshatrat e malësitë nuk mund të ndahet as nga qendrat më të vogla rreth saj: Ulqini, Tivari, Tuzi, Lezha dhe rrethinat e tyre, sepse përjetimi historik ishte i përbashkët, prandaj edhe "...këngët shkodrane të trimnisë nuk kanë kufi vetëm zonën e Shkodrës...".¹ Këngët flasin për qindra e mijëra shkodranë, që kanë derdhur gjakun për të mbrojtur Ulqinin, Hotin e Grudën, sepse në psikologjinë kombëtare ato ishin si rajone të kësaj kryeqendre veriore. Ky konceptim, i konkretizuar edhe në organizimin e tyre në një vilajet në këtë shekull, ka ardhur nga pozicioni strategjik gjeografik i qytetit, nga zhvillimi, veçanërisht i spikatur në këtë shekull dhe nga qëndresa përballë çdo armiku. Siç thotë E. Durham në librin e saj "*Brenga e Ballkanit*" (1905), "*Vilajeti i Shkodrës është më i liri i të gjithëve...Sepse vilajeti i Shkodrës është shtëpia e malësorëve, bijtë e vërtetë të shqipës.*"²

Kënga epike e shek. XIX, përveçse jeton në gojën e popullit, për aq kohë sa kryen funksion estetik, dokumentohet edhe në botimet e mbledhësve të folklorit, të cilët faktojnë tekstet e këngëve dhe sjellin njëherazi edhe variantet përkatëse, duke u bërë e mundur ndjekja e ecurisë së krijimit, gjedhet e hershme dhe ndryshimet gjatë kohërave.

Variantet më të hershme të disa këngëve shkodrane të këtij shekulli na vijnë nga Zef Jubani në *“Përmbledhje këngësh popullore dhe rapsodi poemash shqiptare”*, (Trieste, 1871). Libri i Jubanit pasohet nga përmbledhja e Thimi Mitkos *“Bleta Shqiptare”*, (1878), në të cilën përfshihen disa këngë historike të kohës që po analizojmë. Shumë tekste të këngëve të këtij shekulli i gjejmë në *“Këngë popullore gegnishte”*, të Vinçens Prennushit, (Sarajevë, 1911). Përmbledhja më e plotë e epikës historike shkodrane gjer në vitet “30” është *“Zana Popullore”* e Kasem Taipit, (Shkodër, 1933). Ky botim pasohet nga *“Visaret e kombit”*, vol. I, nr. 3 (Tiranë, 1937) dhe nga botimet e bëra pas Luftës së Dytë Botërore prej institucioneve të specializuara: *“Këngë popullore historike”*, *“Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar”*, kolana me tre vëllime *“Epika Historike”* etj.

Studimi është organizuar në dy pjesë; në pjesën e parë, nëpërmjet vargjeve të përzgjedhura do të mundohemi të tregojmë konkretisht se si ngjarjet më të rëndësishme historike të këtij shekulli kanë gjetur pasqyrim në këngët epike popullore, ndërsa në pjesën e dytë do të përqëndrohemi në përcaktimin e disa veçorive poetike të dallueshme që krijuesi popullor i ka gjetur si më funksionale për të pasqyruar ngjarjet intensive, heroike, plot sakrifica tragjike të asaj kohe.

Epika e pasur e zonës së Shkodrës në shek XIX ishte vijim i një tradite pararendëse. Këngët më të hershme të faktuara të epikës shkodrane i takojnë fundit të shek. XVIII dhe flasin, sidomos për njërin nga pashallarët bushatlinj, Kara Mahmud Pashën, në kohën e të cilit u bënë përpjekje serioze për t’u shkëputur nga Porta e Lartë. Shumë prej këngëve i këndojnë trimërisë së pashait guximtar, duke e veshur me veçori tipike të një prijësi gati legjendar. Kjo ndodh jo vetëm nga sukseset e arritura në kohën e tij dhe për të cilat vendi ishte i etur prej disa shekujsh, por edhe për faktin se oborri i Bushatlinjve mbante pranë vetes muzikantë, poetë, gaztorë, të cilët i thurnin lavde trimërisë së tyre. Këngë të njohura të kohës janë *“Kanga e Mahmud Pashës kur mbet në luftë të Malit të Zi 1796”*,³ *“Sot a dita me fitue”*.⁴

Fillimi i shekullit XIX bëhet burim për vargje të *“Kënga e*

Ali pashë Tepelenës". Në llogoret e Janinës, Pashai i Madh bëri qëndresë, i ndihmuar nga luftëtarë prej të gjitha viseve shqiptare; ndër ta, edhe shkodranë, që sollën gjer në Shkodër jehonën e kësaj epopeje.

Për kohën e pashallëqeve të mëdha bën fjalë edhe kënga "*Toskë e gegë u lidh besa*":

*Iptida ku qe fillesa,/ dy asllana të Shqypnisë,/ toskë e gegë u lidh besa,/ me i dalë para osmanllisë.*⁵

Kënga i kushtohet bashkimit të të gjithë shqiptarëve për të luftuar armikun e përbashkët.

Ka disa këngë që u përkasin ngjarjeve të kohës së Mustafa Pashës, i fundmi i derës së Bushatlinjve, që sundoi gjatë në Shkodër (1809-1831), gjer në rënien e tyre më 1831. Jo të gjithë brezat e Bushatlinjve kanë pasur të njëjtën këmbëngulje për t'iu kundërvënë pushtuesit. Disfata e tij, pas asaj të Pashait të Janinës, vinte pas treçerek shekulli, kur Shkodra me rrethinat kishte marrë më shumë frymë, kishte pasur një ideal të madh për të luftuar osmanllinjte, arriti njëfarë stabiliteti ekonomik dhe zgjimi kulturor. Këngët ngjajnë si copëza të frymëzuara veçmas, që, po të bashkohen me logjikën e rrjedhës historike të kohës, bëhen kronikë artistike e saj. Vargjet bëjnë fjalë për përçarje të mëdha në mes të popullit dhe drejtuesve. Pashai që kishte vënë taksa e haraçe, nuk gëzonte simpatinë e popullit të thjeshtë, i cili nuk e ndoqi më:

*Jusuf begu nip vezirit/ haberin ia dha Tabakut,/ duel nizami në breg të Kirit/ shoqi-shojt ia ndezën barkun./ Se veziri ka çue fjalë,/ tabakët pushkë nuk qesin./ - Hajt beg në Terzihane,/ aty gjen burra që vdesin.*⁶

Tabakët ishin punëtorë zanatçinj që regjnin lëkurë, punonin e jetonin poshtë kalasë, kryenin edhe detyrën e milicisë në raste alarmi në kohën e Kara Mahmud Pashës. Historikisht, ata nuk iu përgjigjën më këtij shërbimi, pasi e ndjenin se punët në drejtim nuk ishin si më parë. Faktin historik, pazotësinë e Mustafa Pashës për të drejtuar, populli e fikson me një varg shumë të thjeshtë, po të shprehur qartë, si të ishte vendimi i një kuvendi popullor: "*Tabakët pushkë nuk qesin.*"

Disa këngë, si kronikë emocionale e ngjarjeve të ndodhura,

sjellin në kujtesë probleme madhore të vendit dhe të këtij qyteti, të cilat ndikuan në fundin e hidhur të vitit 1831.

Fillimi i kryengritjeve popullore kundër pushtuesit osman pas rënies së Bushatlinjve daton në vitet 1832-1833, për të arritur kulmin në kryengritjen e madhe të 1835-ës, drejtuar nga Hamz Kazazi. Tashmë, në Shkodër sundonin vezirë e pashallarë turq nga më tiranët, të cilët shtypnin dhunshëm çdo kërkesë që mund të kujtonte qëndresën e pashallëkut të mundur. Që nga viti 1834, në Shkodër sundonte Hafiz Pasha, veprimet e egra të të cilit nxitën kryengritjen e sipërpërmedur. Ai kërkoi nga populli i lodhur i qytetit 100 djem dhe 75000 grosh për të ndrequr kalanë e Shpuzës, e cila ishte një pikë kufitare strategjike për mbrojtjen e perandorisë nga veriu. Ngjarja e 1835-ës ka shënuar një moment kulmor në historinë e Shkodrës. Kalimi nga njëfarë autonomie relative në një varësi të egër shtypëse ka lënë gjurmë të thella në psikologjinë popullore. Këngët popullore e kanë sjellë këtë përjetim shumë intensivisht.

Ndër këngët e këtyre viteve, shumë e njohur është "*Hafiz Pasha në mot 1836*", që na vjen së pari nga Z. Jubani. Sipas studiuesit Jup Kastrati: "*Kryengritja ka karakter popullor. Ajo plas anekënd Shqipërisë. Masa të gjera lëvizin në jug e në veri. Ato luftojnë me trimëri dhe urrejtje të madhe kundër turqve. Poeti anonim këndon për shqiptarë të cilët luftojnë "me ka një teke e një gjysë kondaku", jo vetëm për t'u çliruar nga zgjedha e pushtuesit osman, por edhe për t'u çliruar nga shtypja e shfrytëzimi ekonomik nga feudalët vendas.*"⁷

Vargjet dëshmojnë shpirtin kryengritës të popullit:

*Ky Hamz Aga burrë i mirë,/ Me tagan, me dy kobure,/ Mos kujtoni ju nizamë,/ nuk asht Shkodra si në Babune.*⁸ "...d.m.th. si në betejën e vitit 1831, kur Mustafa Pasha tradhtoi idealet e luftëtarëve trima shqiptarë."⁹

Një krijim tjetër, *Kanga e Hafiz Pashës* ngre lart shpirtin kryengritës e liridashës të shkodranëve. Egërsia e pashait turk që donte të shtronte Shkodrën me zjarr e hekur, që e pashoqe. Për pasojë, edhe reagimi ishte i rrufeshëm:

*Hafiz Pasha me tetë tabore/ kujton se asht në Manastir,/ kësaj i thonë Shkodër mizore,/ të ban hor edhe rezil.*¹⁰

Banorët e Shkodrës, pasi ishin mësuar vite me radhë të

mos urdhëroheshin prej të huajve, tani e kishin të padurueshme të hynin përsëri nën zgjedhë:

*Këto garibët e Tabakut,/ ku t'i venë, aty qëndrojnë,/ me një pushkë, me gjysë kondakut,/ meterisin nuk e lshojnë.*¹¹

Luftën e bëri gjithë krahina, qytetarët, fusharakët e malësorët. Kënga sikur përshkruan një ushtri të tërë, ku legjionet emërtohen prej vendit nga vijnë:

*Hot e Grudë e Shalë e Shosh,/ Postriba me shkodranë/ yryç, bajnë në Tarabosh,/ nxuerrne krena edhe nizamë.*¹²

Kënga kujton lavdinë e disa viteve më parë, për t'u dhënë zemër trimave. Etërit e tyre e kishin mundur turkun, ishin ndier zotër në shtëpitë e tyre, ndaj kënga risjell në kujtesë kohën kur armiku kthehej mbrapsht me turp:

*Shkodra namin e ka pasë/ veç qetash i qe harrue;/ "Bini, djelm, zoti ju dhashtë,/ për ne daçi me fitue."*¹³

Trimëritë e njerëzve të thjeshtë kanë frymëzuar vargjet:

*Aferim, more ndocjanë/ që i rrini hasmit n'grykë,/ ç'ju grini topi të tanë/ e s'e batë kabull me ikë.*¹⁴

Kryengritja e udhëhequr nga Hamz Kazazi është ngjarja e parë madhore pas rënies së Bushatlinjve. Ajo do të pasohet nga shumë të tjera në këtë shekull plot gjak e dhembje, kur populli luftonte kundër bishës tashmë të lodhur, por që në përpëlitjet e fundit tregohej më e egër se kurrë. Këngët janë dëshmitare të tmerreve të luftës:

*Te xhamia e Haxhi Bajramit/ u dha tym e u dha flakë,/ aty ndodhen zogjt e shkodranit,/ nizamën e hoqën në shpatë.*¹⁵

Kënga e përshkruan Hamz Kazazin të trimëruar, sepse kishte me vete Shkodrën mbarë dhe luftonte i ndjekur nga forca e mijëra luftëtarëve:

*Hasan Hoti thotë një fjalë:/ -Hafiz Pasha më ndigjo mue,/ me kapë Shkodra pushken mbarë/ një s'e len me teprue.*¹⁶

"Kënga e Selos së Haxhi Kasemit" flet për një djalë populli që u printe në raste nevoje, luftëtarëve të lagjes "Ndocej", i njohur historikisht si bashkëluftëtar i Hamz Kazazit më 1835. I shquar si trim, ai shfaqet personazh real edhe në luftën e Dasho Shkrelit dhe këngën e krijuar për atë. Sipas të dhënave historike, organizimi popullor ishte i admirueshëm në rajonet e qytetit. Ky personazh luftoi në lagjen "Tabakë" kundër turqve, u plagos

e vdiq nga plagët, siç thotë kënga:

*Ç'ka po thotë Hafiz Pasha i ngratë:/ - Qorr Selim, si t'ja bajmë?/
Hini Selja ndër Tabakë,/ t'i vemë top edhe havan!/ .../ Ky Selja
bajraktari/ porsi t'ishte një drague,/ në meteris kërceu i pari/ i ra topi
e ka shëmtue./ .../ Hafiz Pasha rrahë shuplakë/ hini Selja ndër Tabakë,
Selja i Haxhi Kasemit,/ porsi tuba e fasligenit.¹⁷*

Populli nuk e përmend fjalën vdekje. Ai fikson shëmbëllimin e saj të llahtarshëm, të frikshëm: "I ra topi, e ka shëmtue."

Një ndër këngët shumë të njohura tregon urrejtjen për valiun e huaj, Ismail Pashën, të cilin kryengritja popullore e detyroi të largohej me turp më 1870. Ky vit shënon raprezalje të mëdha ndaj kryengritësve, të cilët nuk kishin arritur të organizoheshin mirë dhe humbën në luftë 170 burra, kryesisht luftëtarë malësorë. Pas kësaj ngjarjeje, për të qetësuar disi gjendjen, Porta e Lartë e tërhoqi këtë pasha xhahil, i cili u ndoq me gurë rrugës, tek ikte nga Shkodra:

*Ismail Pasha kryet si lopa/ ç'e rrethoi Shkodrën me topa,/ me
topa e me havana,/ se moj Shkodër, mirë ta bana./ Mori Shkodër,
moj mizore,/ pak u duke, shumë na dole,/ me ba luftë me tre tabore,
Smajl Pashën ç'e marrove...¹⁸*

Vargu "Pak u duke e shumë na dole" dhe vargu që do lindë vite më vonë "Jena nisë me u ba milet" në poezinë tonë popullore janë si leitmotive të ngjarjeve madhore të këtij shekulli.

Në shek. XIX popullit tonë i është dashur të luftojë me disa armiq njëherësh e të cilët shpesh bashkoheshin në synimet e tyre të mbrapshta. Kufiri verior i vendit ka qenë i kërcënuar nga forcat malazeze, që kanë synuar jo vetëm Ulqinin e krahinat e tjera në kufi, por edhe vetë Shkodrën. Kënga, nëpërmjet përjetimit emocional të ngjarjeve, reflekton luftërat në Tivar, Shpuzë, Kërnice, luftën e Oso Kukës në Vraninë, reagimin ndaj vendimeve të padrejta të Kongresit të Berlinit dhe 1913-ën e dhimbshme. Kënga nuk merret shumë me shpjegimin historik, faktin e merr si të njohur mirë prej të gjithëve, po ndalet sidomos në qëndresën ndaj së keqes nga i gjithë populli, veçanërisht ngre lart figura luftëtarësh dëshmorë.

Historia e Shqipërisë tregon se luftërat e bëra në Veri ndikuan ndjeshëm në zhvillimin e ngjarjeve në këtë shekull.

Pikë kulmore e lëvizjes shqiptare kundër turqve është Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878), qëllimet kryesore të së cilës ishin pavarësia e vendit nga turqit dhe lufta kundër copëtimit të trojeve tona.

Edhe në Shkodër, idetë e Lidhjes bashkuan rreth patriotëve që dolën në ballë, gjithë popullin, pa dallim feje. Qyteti i Shkodrës, i kërcënuar drejtpërdrejt nga fqinjët, përmes degës së Lidhjes në Shkodër, më 10 qershor 1878 i dërgoi një protestë me 500 firma Kongresit të Berlinit, ku dënonte copëtimin e tokave shqiptare nga Traktati i Shën Stefanit (3 mars 1878), i bërë mes Turqisë dhe Rusisë.

Kongresi i Berlinit i jepte Malit të Zi Plavën e Gucinë, marrjen e të cilave knjaz Nikolla premtoi ta bënte edhe me luftë. Këtij kërcënimi, 300 djem shkodranë, të organizuar nga dega e Lidhjes së Prizrenit për Shkodrën, iu përgjigjën me një betejë të ashpër, që u zhvillua në Nikshiq, më 4 janar 1880. Fitorja e kësaj lufte e detyroi Malin e Zi të tërhiqej nga kërkesa për Plavën e Gucinë dhe, në vend të tyre, me arsye shumë dinake, kërkoi Hotin e Grudën. Që në këtë luftë fillojnë të shquhen figura trimash, si: M. Shpendi, M. Uci, D. Gj. Luli etj. të cilët do të jenë protagonistë të disa këngëve popullore. Lufta për mbrojtjen e Hotit dhe Grudës, e udhëhequr nga Hodo Sokoli dhe që arriti të bëhej jo vetëm me armë, por edhe në luftime trup me trup në brigjet e lumit Cem, u fiksua në vargjet shumë të njohura popullore të *"Kanga e Luftës së Miletit"*.

Kronika artistike e luftërave të përgjakshme vijon me ngjarjet e hidhura që pasuan. Duke parë qëndresën e popullit shqiptar Fuqitë e Mëdha, Perandoria Osmane dhe Mali i Zi, u shtrënguan të lironin Hotin e Grudën dhe ranë në ujdi t'i aneksonin këtij të fundit Ulqinin deri në breg të lumit Bunë, sepse aty mund ta shtronin këtë popull "të pabindur" edhe me ndihmën e flotave luftarake. Pas betejash të ashpra, Ulqini ra. Kronikat dhe këngët popullore tregojnë se vdekja e udhëheqësit popullor Jusuf Sokoli u kthye në një manifestim të madh popullor kundër osmanëve dhe Fuqive të Mëdha:

*Isuf Sokoli vaj,vaj,/ ç'po të qan sot vegjlia, vaj, vaj.*¹⁹

Edhe *"Kanga e Beqo Qoshes"*, vrrarë më 1880, flet për vdekjen e tij heroike në emër të idealeve të Lidhjes së Prizrenit:

*Ç'ka ka Rusi që po dridhet?/ Beqir Aga nuk po lidhet.../ Pse s'po lidhe, Beqir Aga?/ Nuk po lidhem për dy herë/ se m'ka lidhë nana një herë.*²⁰

U munduam të sillnim në këto radhë një kronikë me vargje të spikatura të këngëve epike shkodrane të shekullit XIX, që vetë populli i krijoi për të përjetësuar shpirtin patriot, vetëdijen atdhetare, për t'ua lënë si kujtesë brezave qëndresën e pashembullt në shekullin e fundit të sundimit osman. Kjo kronikë për ngjarjet kryesore të shek. XIX, me citime vargjesh dhe shpjegim të tyre në lidhje me faktin historik që i lindi, mund të pasurohet me qindra këngë të tjera të epikës historike shumë të pasur të zonës së Shkodrës. Por ky plotësim bëhet edhe individualisht, duke lexuar përmbledhjet përkatëse me këngë të epikës historike. Është në interes të studimit të ndalemë në disa veçori tipike të mënyrës së përjetimit emocional të ngjarjeve historike në këto këngë.

*
* *
*

Lidhja kohë-krijim artistik është shumë e vjetër dhe ka të bëjë me nevojën e njeriut për të përcjellë emocionet e përftuara drejtpërdrejt prej ngjarjeve më të spikatura të kohës në folklorin gojor. "*Çdo këngë historike është dëshmi e personalitetit të kombit*".²¹

Kënga historike, siç e vumë re, është si një lloj arkivi artistik, kujtesë e ngjarjeve të mëdha për brezat dhe dëshmi e identitetit kombëtar. Rajoni i Shkodrës ka specifika në këngët historike, të cilat lidhen me veçori etnologjike dhe psikologjike, të lindura nga mënyra e jetesës dhe gjatë përballjes me historinë. Megjithatë, historia dhe kënga që frymëzoi ajo në këtë rajon, janë si pjesa mbi të tërën, krijuar në të njëjtin kontekst historiko-kulturor, një pjesë e gjithë historisë kombëtare dhe e përjetësimit të saj në artin gojor të popullit.

Kënga popullore shumë natyrshëm ka arritur të realizojë kronikën e ngjarjeve të rëndësishme që përshkuan këtë zonë në njëqind vjetët e trazuar të shekullit XIX, kur Shkodra ishte protagoniste e stuhive me përmasa kombëtare. Qyteti më i madh verior i vendit ka qenë gjithnjë një kryeqendër, ku janë kryqëzuar

rrugët e Shqipërisë nga lindja në perëndim, nga jugu në veri. Ky pozicion e ka bërë të ketë peshë në aspekte jetike të rëndësishme, si: në atë historik, social, kulturor, urban, demografik. Ngjarjet e mëdha që përmendëm, ku Shkodra pati peshë të ndjeshme, kanë gjetur pasqyrim artistik në gojën e popullit me ndihmën e një poetike të veçantë, e cila ka bërë të mundur që këngët të jenë kushtruese, eksklamative, shpesh shoqëruar me retorizëm të lartë.²²

Kënga epike folklorike, duke ndjekur rrjedhën historike, karakterizohet nga një *realizëm i dallueshëm*. Duke shfaqur natyrshëm thelbin e njeriut shqiptar, kënga përfshin në orbitën e vet artistike ndodhi, tipa, karaktere që realisht ishin protagonistë dhe ndikuan në proceset historike.

Karakteri përzgjedhës ndaj së vërtetës historike është me interes të nënvizohet. Analiza dhe sinteza veprojnë në simbiozë të habitshme, duke u përqëndruar në atë që është vërtet e rëndësishme. Në këtë proces ka vepruar edhe seleksionimi që ka bërë koha. Ndalja në raportet me Perandorinë Osmane, me Fuqitë e Mëdha, me Malin e Zi, në marrëdhëniet me krahinat e tjera shqiptare, në veçoritë problematike që paraqet ky qytet, në sakrificat e tejskajshme që iu desh popullit të bënte për të mbijetuar, flasin për koherencë të këngës popullore dhe lënie mënjanë të gjërave të rastit.

Këngët epike janë kujtesë historike kombëtare, që e marrin frymëzimin nga ngjarje unikale me karakter përgjithësues. Ato nuk e riprodhojnë realitetin me gjuhën e dokumentit historik, po marrëdhënia në mes të gjetjeve artistike dhe fakteve reale është shumë e ngushtë.²³ Frymëzimi për një motiv nga realiteti shpreh një vështrim poetik të caktuar, një mënyrë të të menduarit artistik, në raport me të vërtetën historike. Është domethënës fakti që shpesh autorët e këtyre këngëve kanë qenë protagonistë ngjarjesh, kanë luftuar në një front me të rënët në luftë dhe frymëzimi u ka ardhur si shfaqje e ndjesive emocionale të jetuara intensivisht.

Shtjellimi i faktit historik më gjatë dhe me më shumë detaje vjen nga *këngë të gjata, të natyrës tregimtare apo reflektive*.

Pjesa më e madhe e këngëve ka një nyje subjekti, i cili shtjellohet brenda mundësive të llojit. Këngët përshkruajnë me

vërtetësi ngjarjet. Por shpesh nuk përqëndrohen shumë në të gjitha elementet e ngjarjes. Mënyra se si tregohet apo nënkuptohet ndodhia, synon që kënga të marrë një kahje poetike të përcaktuar. Këngëtari popullor ndalet më shpesh në jehonën e ngjarjes, sidomos kur kënga ka një hero martir. Në këto raste, teksti i këngës karakterizohet nga gjuhë emocionale që reflekton tragjiheroizëm, qëndrimi ndaj motivit të trajtuar është tejet i hapur, pa lënë asnjë ekuivok. *“Kulti ndaj këngës te shqiptarët mori atë përmasë sa u ngrit edhe mbi vetë jetën Janë të njohura këngët ku individët që sakrifikuan për familje, për fis, popull e atdhe - në esencë e këmbyen jetën me këngë Në këngë individi bëhej i pavdekshëm ... e i këndohej në qindra mënyra.”*²⁴

Epika historike shkodrane është shumë e pasur me *këngë trimash*. Ato i karakterizon vdekja e heroit për idealin e madh të lirisë. Kryesisht, janë bërë e kanë vijuar të jetojnë këngë për heronj me vlera të shumanshme, të përmasave kombëtare, të cilët përshkruhen sidomos në çastin e rënies. Të tilla janë *“Kanga e Oso Kukës”, “Kanga e Dasho Shkrelit”, “Kanga e Mehmet Shpendit”*. Humbja e jetës për ideale të mëdha konsiderohet si e arsyeshme dhe e domosdoshme. Theksohet momenti i vdekjes, që i jep këngëve të kësaj natyre nuanca tragjike të theksuara. Kënga, për ta bërë edhe më jetësor e funksional personazhin, krahas veprimtarisë politike e shoqërore, përshkruan edhe veti të dallueshme morale e shpirtërore të tij. Ndonjëherë është e pranishme *nëma* në fund të këngës, duke përforcuar kështu edhe më mirë mesazhin artistik:

1 ... *Më vrau Veziri me do keqana,/ me do keqana, he e qaftë e ama,/ e qaftë e ama e e qaftë e motra,/ me qeserë iu mihtë votra.*²

2 ... *Ç’ka po thotë e mjera Shkodër:/ -Imdat paçim perendinë,/ me lot qan i madh e i vogël,/ na u dogj Osja në Vraninë.*²⁶

3 ... *Kush po i ngjitet malit për pjetë,/ Dasho Shkreli sokol me fletë./ Kush po i ngjitet malit për t’gjanë,/ Dasho Shkreli me shkodranë/ .../ Dasho Shkrel, të raftë zana/ nëpër male të kërkon nana,/ kah len dielli e perëndon hana.*²⁷

Këngët e trimave shquhen për skicim emocional prekës të tipave e karaktereve. Vetitë e protagonistive realizohen përmes veprimeve, tipareve fizike, sidomos duke përshkruar ngjarjen

ku ai mbetet.

Këngëtari popullor ka ndjekur dy rrugë për të krijuar imazhin e heroit: duke folur për protagonistin në mënyrë pavetore ose duke u vetëshpalosur vetë ai:

1...Ç'a ka Rusi qi po dridhet?/ Beqir aga nuk po lidhet.²⁸

2...Hajde, hajde Osman Aga,/ për dyrnja s'paske mendu,/ në katër anët t'u dha flaka,/ nami yt s'ka me u harru.²⁹

3...Dasho Shkreli fjalë ka çue/ thueji nanës jam varrue,/ dymdhet plumba më kanë përshkue./ Deri në Kamicë kambë kam shkue,/ vetvedin e kam pague.³⁰

Karakteristikë e këtyre këngëve është *vlerësimi i madh i jetës*. Në krijimet e tij populli e konsideron si sakrificë sublime dhënien e saj në kontekstin e gjerë të jetës së popullit, në një kohë të caktuar historike kur vendi e kërkon.

Këngët karakterizohen nga *pathosi heroik*. Historia e hidhur e këtij shekulli i detyroi shkodranët të përballonin me durim dhembjen për humbjen e njerëzve të dashur. Nga vargjet, duket se njerëzit sikur ishin mësuar me gjendjen e imponuar të luftës, të parapërgatitjes për të, të qëndresës stoike si para një të keqeje që duhet medoemos të përballohej pa u dhënë, pa u dobësuar e ligështuar, se vetëm me rezistencë e sakrificë do të mbijetonin:

Duel xhevapi prej sarajit:/ -Hajt, shkodranë, gati me u ba,/ Karadaku i ra Tivarit./ Gjithë Shkodra në kambë u çu./ .../ E kanë ndejë tre muej e pak,/ ditë e natë tue luftue,/ askërkush s'iu shkoi imdatë,/ edhe buka iu asht mbarue.³¹

Duket sikur populli ka fituar imunitet ndaj luftërave, sa edhe situatat më të vështira që kërcënojnë jetën drejtpërdrejt, i pohon thjesht si të këqija të pritshme.

Qëndrimi burrëror para vdekjes, i përshkuar nga ideja e sakrificës për kombin, ishte një lloj gjetjeje artistike për të zbutur dhembjen.

Populli i kushton shumë vend në këngë *amanetit të të flijuarve*. Ai është si një gjëzim i ardhur nga një botë tjetër, si jehonë shungulluese që duhet ta dëgjojë gjithkush, jo vetëm personi i dashur të cilit i është drejtuar. Kënga ia lë amanetin nganjëherë gruas, motrës, po përgjithësisht njeriut më të

besueshëm, nënës, së cilës zemra do t'i dhimbte më shumë se të gjithëve për birin e humbur:

1. *Amanet po ta la moj nanë,/ Ma ban gurin pak të gjanë,/ Sa t'ma shkruaj ustahi taganë*³².

2. *Amanet ti moj grue/ Mos kqyr me u martue/ Dërsa t'gjesh nji burrë si mue!*³³

Kënga i krahason trimat me lulet, për t'u kujtuar brezave se të rinjtë që vdesin kështu, janë si lule të jetës që këputen e nuk do të mund të lulëzojnë më.

Dallohet qartë në këto këngë ndryshimi i tejskajshëm i vdekjes së lavdishme me vdekjen me turp. Askund kënga nuk merret me vdekjen si me një proces natyral. Figurat që ndodhen në vargje, janë ose të shenjtëruara në pedestal, ose të mbuluara me faqen e zezë. Kjo mënyrë pasqyrimi nxjerr edhe më në pah heroin që vdes për idealet e kombit. Kur këndohet për trimat, vargjet sa e thellojnë, aq edhe e zbusin dhembjen, ngrenë në pedestal sakrificën, duke nxjerrë më në pah vlerat e jetës njerëzore.

Me shumë thjeshtësi këngët shtjellojnë subjekte tragjike që u referohen të vërtetave të ndodhura. Vetëflijimi është ngritur në kult. Të parët e vdekjes në sy, sakrifikimi sublim duke qenë krejt i vetëdijshëm për çka po ndodh, janë bosht i shumë prej këtyre këngëve. Duke ndjekur këtë formë të pasqyrit artistik, kënga shkodrane i ka bërë të pavdekshëm Dasho Shkrelin, Selo Kasemin, Oso Kukën, Mehmet Shpendin. Në këngën e luftës së Kërnicsës përshkruhet gati si mitologjike figura e Mustaf Brocit, luftëtar dëshmor, për të cilin gojëdhëna thotë se, edhe pasi ia kishin prerë kokën, arriti të mbahej shtatë-tetë hapa në këmbë:

*Ç'po shiqon Nikolla me sy,/ po lufton Broci pa kry.*³

⁴

Realizimi me gjuhë figurative i heroit është mbresëlënës. Përdoret kuptimi i parë i fjalës, krahas apostrofimit, krahasimit, personifikimit, metaforizimit, figura që ndihmojnë për t'i përshkruar karakteret më intensivë, më të thellë, më të plotë.

E rrallë për nga mjeshtëria e gdhendjes së heroit të vetëflijuar, është kënga e Oso Kukës, në të cilën kujtesa artistike folklorike i ka dhënë figurës dimensione gati legjendare. Kënga i referohet ngjarjes së vërtetë, kur ai bashkë me shokët u dogjën

për së gjalli në kullë të Vraninës më 1862, për të mos rënë në dorë të armikut. Kënga e cilëson Oso Kukën të pavdekshëm, të tillë e konsideron historia dhe kujtesa popullore (në gurin e varrit të tij ka të gdhendur një shpatë, gjë që ndodhte tepër rrallë, vetëm kur bëhej fjalë për trima të shquar). Në këngë figura e këtij heroi herë vetëshpaloset e herë reflektohet për atë nga krijuesi:

*Pa ndigjo, more Nikollë Popi/ a s'ke pa shkodran me sy,/ mue më thonë Oso Baroti/ që djeg vedin edhe ty.*³⁵

Kënga ka pathos tragjik kur kujton vdekjen e llahtarshme në kullë të Vraninës:

*Ç'ka po thotë e zeza Shkodër!/ Na ndihmë paçim përendinë,/ me lot qan i madh e i vogël,/ u dogj Osja në Vraninë.*³⁶

Kënga e Oso Kukës frymëzohet jo vetëm prej këtij rasti, ajo këndoi për ngjarje të ngjashme të ndodhura më parë dhe që do të ndodhnin në të ardhmen në këtë shekull të zymtë, kur Shqipëria duhej të vetësakrifikohej për të vazhduar të ekzistonte. Kënga e kthen figurën e Osos Kukës në simbol për brezat që vijnë. Me fjalët e thjeshta "Nuk ke pa shkodran me sy", i thuret kurorë dafinash Osos së kullës së barotit dhe gjithë atyre që i dhanë nam Shkodrës. Kënga fakton lot në faqet e burrave, shtëpi të mbetura shkret, fëmijë që vdesin pa u rritur. Kujtesa artistike popullore ka thujse gjithmonë fjalët "qen" e "i pabesë" për armikun.

Misioni estetik dhe historik i këngës përmbushet sidomos kur kënga i flet aktualitetit dhe së ardhmes:

*Hajde, hajde Osman Aga,/ për dyrnja s'passe mendue,/ n'katër qoshet t'u dha flaka,/ nami yt s'ka me u harrue.*³⁷

Kënga e Oso Kukës është ndër më të veçantat e epikës sonë historike, por këngë të ngjashme trimash ka shumë në zonën e Shkodrës. Duke i kënduar një trimi, populli realizonte disa misione të këngës, i ngrinte pedestal heroit, fiksonte historinë për t'ua thënë brezave, jepte shembuj konkret të bijve që e deshën shumë atdheun, i fliste emocionalisht të sotmes dhe të ardhmes. Për të realizuar këtë mision, janë gjetur gjithnjë forma të reja, që kanë ngjashmëri me të mëparshmet, po që dallohen nga veçoritë e secilit rast.

Në epikën popullore shkodrane ka disa këngë për ngjarje të përmasave të mëdha kombëtare, që bëjnë konkluzione dhe marrin trajtën e thirrjeve kushtruese. Janë *këngë reflektive*, të cilat, krahas epizmit të theksuar, pasurohen me elemente tragjike dhe lirike. Kanë strukturë të ngjeshur; ngjarja për të cilën këndohet, merret si e njohur nga dëgjuesit. Krijimi merr përsipër të saktësojë dhe të analizojë faktin historik. Mendimi që reflekton kënga, arrihet nga çdo detaj i saj. P.sh. në këngën e cituar më poshtë, çdo varg mbart idenë e urrejtjes për armikun:

*Smajl Pasha, kryet si lopa/ ç'e rrethoi Shkodrën me topa,/ me topa e me havana,/ se moj Shkodër, mirë ta bana,/ t'hoqa armët e tagana,/ t'laç ndër shalla, ndër fistana./ Mori Shkodër, moj mizore,/ pak u duke, shumë na dole,/ bane luftë me tre tabore.*³⁸ Ka disa këngë të tilla shumë të spikatura për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, aktivitetet e së cilës në Shkodër u konkretizuan me një qëndresë shumë të organizuar.

Këto këngë kanë synim realizimin e një mendimi përmbledhës, të një mesazhi sa më të plotë, i cili nënvizohet sidomos në kulmin dhe mbylljen e tyre; përcjellin ide të kuptueshme, sepse flasin qartë, thjesht dhe hapur, duke analizuar e sintetizuar faktin historik. Të kësaj natyre janë këngët "*Del moj Shkodër një për shpi*", "*Do t'luftojmë na për Shqypni*", "*Nuk po bjen Kelmendi n'dorë*", "*Iptida u kndu fermani*", "*E ka mbyllë Shkodra pazarin*" e shumë të tjera.

Tipike si këngë që shpreh mendim e refleksion të thellë për ngjarjet historike është "*Kanga e luftës së miletit*". Po i drejtohem kësaj kënge për të dalluar nëpërmjet vargjeve se sa shumë mendim mund të përmbajë një këngë, sa realisht e shpjegon kohën dhe sa vizion të qartë kishte populli në qëndrimet e tij. Në pjesën e parë të këtij shkrimi u sqarua se në çfarë rrethanash u zhvilluan luftërat e ashpra për jetë a vdekje, që iu desh të përballonte Shkodrës dhe malësive, për të mos lënë jashtë trojeve asnjë pëllëmbë të tokës shqiptare. Në këtë këngë, që shtjellon problemin e sipërpërmendur, bie në sy koncentrimi i madh i mendimit, informacioni i pasur, konceptimi i qartë i mikut e i armikut, dhënia e vendit që i takon prijësit dhe luftëtarëve në betejë. Koha e kishte mësuar popullin se lufta ka nevojë për prijësa:

Shkodër e Malci janë çue/ donë me gjetë një komandant/ Hodo Pashën kanë emnue,/ nuk ka çajre pa ju ardhë.³⁹

Dhe historia thotë se Hodo Sokoli, ushtarak në shërbim - në kështjellën e Shkodrës jep menjëherë dorëheqjen, "shkepi format e mirallajit", duke iu përgjegjur thirrjes së popullit të qytetit të tij. Kënga veçon, si moment me rëndësi vendimtare për një luftë të përmasave të tilla, mbështetjen e Shkodrës nga e gjithë Shqipëria.

Analiza e sinteza, të bëra në pak vargje, gjejnë arsyet pse u bënë aq të vështira ato beteja dhe pse nuk funksionoi deri në fund kushtrimi i hedhur në Lidhjen historike të Prizrenit.

Iptida do ditë përpara,/ Këndojnë xheridet e Stambollës,/ Hot e Grudë na i doli fjala,/ Ia ka falë mbreti Nikollës.

Fillimi i këngës, që kumton se tokat shqiptare po i jepen të huajve, është tepër indinjues. Pas ligjërimin, në dukje të shtruar e të qetë, lakonik e të saktë, siç shprehen zakonisht malësorët, fshihet zemërimi i madh i mbarë popullit, me fatet e të cilit luajnë ata që e kishin zaptuar, lodhur e drobitur për shekuj. Malet ulen në Shkodër "me qa dert"; aty e kanë shpresën, themelin, aty gjejnë urtësinë e u mbrohen krahët:

Ia dha Shkodra besën Hotit,/ m'at sabah që të dalë nizami/ ia mbërrijmë me besë të zotit/ bashkë me ju te istikami.

Kënga është si kërcënim për çfarëdo armiku të tokës shqiptare:

Krisi pushka, disa topa,/ sa me vrap u kthye urdia,/ e mori vesht gjithë Europa/ asqer trim paska Shqipnia.

Pasojat e hidhura të luftës, djemtë e vrarë nuk bëhen objekt i këngës, ato nënkuptohen, pasi vargjet dëshmojnë krisma armësh, topa, llogore, istikame, batalione, përmendin Shkodrën, Tiranën, Dibërën, Rrzhanicën, Stambollin, Ulqinin, Hotin, Grudën dhe kujtojnë personazhe të njohur historikisht.

Hot e Grudë ishin bashkue,/ erdhën n' Shkodër me qa dert,/ pa gjak malet mos me i lshue,/ kena nisë me u ba millet.⁴⁰

Vargu i shprehur me gjuhën e thjeshtë të popullit "Kena nisë me u ba millet" është konkluzion i një përvoje të gjatë, i ndodhive të dhimbshme të cilat i ndërgjegjësuat njerëzit se për se duhej luftuar dhe sakrifikuar jeta në këtë fund shekull, kur fitorja ndihej të ishte pranë. Mbyllja e këngës është optimiste:

Vojt xhevapi ndër Shahllarë,/ krisi pushka në istikam,/ duel

mileti me faqe të bardhë.

Thjeshtësia dhe të folurit pa ekuivoqe ngulmojnë për qartësi dhe objektivitet në shikimin e problemeve. Ndonëse u deshën edhe disa vite luftërash dhe fitoret u paguan shtrenjtë, vargu *"Kena nisë me u ba milet"* paralajmëroi ngadhënjimin, që do të bëhej realitet me shpalljen e pavarësisë dhe mbeti si ndër më domethënësit e gjithë epikës sonë.

Shqyrtimi që bëme për pasqyrimin e fakteve historike të shekullit XIX në këngët popullore epike të zonës së Shkodrës mund të plotësohet me vështrimin e mijëra këngëve të zonave të tjera të vendit, për të dëshmuar se në gjithë Shqipërinë populli ruajti historinë e tij ndër këngë, krijime që, përveç funksioneve emocionale, shërbejnë edhe si faktor identiteti, afirmimi dhe ruajtjeje në kujtesën popullore të fakteve të rëndësishme historike.

BIBLIOGRAFI

1. Edith Durham, *"Brenga e Ballkanit"*, Tiranë, 1998.
2. Hamdi Bushati, *"Shkodra dhe motet"*, v. I, Shkodër, 1998.
3. Hamdi Bushati, *"Shkodra dhe motet"*, v. II, Shkodër, 1999.
4. *"Histora e Popullit Shqiptar"*, v. II, Tiranë, 2002.
5. Injac Zamputi, *"Fishta, koha, njeriu, vepra"*, Tiranë, 1993.
6. Jup Kastrati, *"Zef Jubani. Vepra të zgjedhuna"*, parathënie, Tiranë, 1966.
7. Kasem Taipi, *"Zana popullore"*, Shkodër, 1933.
8. Kolë Gurashi, *"Shkodra e baballarëve"*, Shkodër, 2002.
9. *"Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar"*, Tiranë, 1961.
10. Qemal Haxhihasani, *"Thimi Mitko. Bleta Shqiptare"*, Parathënie, Tiranë, 1981.
11. Robert Elsie, *"Historia e letërsisë shqiptare"*, Pejë,

1997.

12. T. Daija, T. Zadeja, "250 këngë qytetare shkodrane", Shkodër, 2000.
13. Vinçens Prennushi, "Kangë popullore gegnishte", Sarajevë, 1911.
14. "Visaret e kombit", v. I, Tiranë, 1937.

¹ Injac Zamputi, "Fishta, koha, njeriu, vepra", Tiranë, 1993, f. 136.

² "Bregna e Ballkanit", Tiranë, 1998, f. 334.

³ Zef Jubani "Vepra të zgjedhura", Tiranë, 1966, f. 116.

⁴ Kasem Taipi, Zana Popullore, f. 70.

⁵ Kasem Taipi, "Këngë popullore shkodrane", Shkodër, 1998, f. 77.

⁶ Hamdi Bushati, Shkodra dhe motet, Shkodër, 1998, v. 1, f. 507.

⁷ Jup Kastrati, "Zef Jubani, vepra të zgjedhuna", Tiranë, 1966, Hyrje, f. 34.

⁸ Po aty, f. 122.

⁹ Po aty, f. 34.

¹⁰ Po aty, f. 123.

¹¹ Po aty, f. 123.

¹² Po aty, f. 124.

¹³ Po aty, f. 124.

¹⁴ Po aty, f. 81.

¹⁵ Kasem Taipi, v. e cit., f. 68.

¹⁶ Hamdi Bushati, v. e cit., v. I, f. 516.

¹⁷ Hamdi Bushati, v. e cit., v. I, f. 531.

¹⁸ Kasem Taipi, v. e cit., f. 79.

¹⁹ Hamdi Bushati, v. e cit., v. I, f. 495.

²⁰ Kasem Taipi, v. e cit., f. 95.

²¹ Qemal Haxhihasani, Parathënie, "Bleta shqiptare", Tiranë, 1981.

²² Historia e popullit shqiptar 2, Tiranë, 2002, fq. 213.

²³ Qemal Haxhihasani, v. e cit., fq. 10.

²⁴ Anton Berisha, "Gjurmime albanologjike", 1/1991, Prishtinë.

²⁵ Kasem Taipi, v. e cit., fq. 6.

²⁶ Epika Historike 2, fq. 185.

²⁷ Kasem Taipi, v. e cit., fq. 40.

²⁸ Epika Historike 2, fq. 62.

²⁹ Epika Historike 2, fq. 205.

³⁰ Kasem Taipi, v. e cit., fq. 40.

³¹ Kasem Taipi, v. e cit., f. 118.

³² Kasem Taipi, v. e cit., f. 130.

³³ Kasem Taipi, po aty, f. 130.

³⁴ Hamdi Bushati, v. e cit., v. I, f. 419.

³⁵ Kasem Taipi, v. e cit., f. 168.

³⁶ Po aty.

³⁷ Po aty.

³⁸ Epika historike 2, fq. 193.

³⁹ Hamdi Bushati, v. e cit., v. I, f. 440.

⁴⁰ Kasem Taipi, v. e cit., fq. 108.